



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.146, datë 30.10.2020

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA GRANTI I RIKONSTRUKSIONIT

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, vendimit nr. 540, datë 08.07.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njësisve të banimit në ndërtesa (pallat) si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat (pallat) në bashkitë Durrës, Tiranë, Lezhë, Krullë dhe Kavajë”, si dhe vendimit nr. 57, datë 01.06.2020 të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit dhe miratimit të udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit”, urdhrit nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit të Komisionit të Posaçëm, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit të komisionit të posaçëm për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit (granti rikonstruksionit), banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
2. Të miratojë sipas kategorive të dëmit DS1, DS2 dhe DS3, listën emërore të subjekteve përfituese nga granti i rikonstruksionit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Bashkia Tiranë ngarkohet të korrigjoj gabimet në rast se evidentohen në listen e përfituesve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe në aktet e tjera të Këshillit Bashkiak që kanë për objekt shpalljen e listave fituese nga grantet e rikonstruksionit. Korrigjimet i paraqiten këshillit bashkiak për miratim.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.
5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtorja e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtorja e

Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe njoftohet publikisht.

K R Y E T A R

TONI GOGU